

16.08.2023  
Ora 13:11

**RENDI I DITËS**

Projektvendim “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për Kryetar në Bashkinë Kukës që do të zhvillohen më datë 24 shtator 2023”.

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• **Komisioni Rregullator:**

• Ilirjana	NANO	Kryetar
• Arens	ÇELA	Anëtar
• Dritan	ÇAKA	Anëtar
• Helga	VUKAJ	Anëtar
• Muharrem	ÇAKAJ	Anëtar
• Stafi	KQZ	Znj. M. Koja
Parti	Politike:	S’ka prezent
Të	tjerë:	KRIIK (Z. Dritan Taulla)

**Znj. I. Nano:** Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Mbledhja e Komisionit Rregullator zhvillohet në kuadër të një palë zgjedhjeve të reja që do të zhvillohen ne 24 shtator 2023, për kryetar në Bashkinë Kukës, sipas dekretit të Presidentit të Republikës numër 186 datë 11.08.2023. Në rendin e ditës së mbledhjes kemi vetëm një akt për të shqyrtuar, projektvendimin “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Kukës që do të zhvillohen më datë 24 shtator 2023”. Nuk është hera e parë që miratojmë akte të kësaj natyre dhe në

Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

zgjedhjet e pjeshme të datës 6 mars 2022 dhe në zgjedhjet që u përsëritën në Rrogozhinë këtë vit, janë miratuar disa afate proceduriale për shkak se Kodi Zgjedhor nuk i parashikon këto afate. Kodi parashikon afate të tjera që lidhen me zgjedhjet e zakonshme, qoftë për zgjedhjet për kuvendin, qoftë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, zyrtarë të lartë të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësues të mediave dhe të shoqërisë civile. Përpara se të fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit do të pyesja kolegët nëse kanë diçka jashtë rendit të ditës. Kolegë? Nuk ka çështje jashtë rendit të ditës! Fillojmë me këtë projektvendim. Zonja Koja ju lutem në mënyrë të përmbledhur projektaktin të na paraqisni dhe relacionin shoqërues, faleminderit!

**Znj. M. Koja:** E nderuar Kryetare e Komisionit Rregullator, të nderuar anëtarë, sot Komisioneri vjen me një propozim për një projektvendim që lidhet me disa afate proceduriale që lidhen me zgjedhjet e pjeshme për Kryetarin e Bashkisë Kukës. Sikundër ju referuat më lart Presidenti ka dekretuar datën 24 shtator 2023 për zhvillimin e zgjedhjeve në Bashkinë Kukës. Në zbatim të detyrimeve ligjore të Kodit Zgjedhor në këtë projektvendim parashikohen afate proceduriale të cilat janë të reduktuara në kohë dhe respektojnë kronologjinë e veprimeve të cilat parashikohen nga Kodi Zgjedhor, sikundër është:

- kohëzgjatja e fushatës zgjedhore;
- detyrimi i institucioneve për të raportuar veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në Bashkinë Kukës apo në funksion të kësaj bashkie; monitorimi i OSHMA-ve nga AMA;
- përcaktimi i afatit për subjektet zgjedhore për paraqitjen e propozimeve për anëtar të komisioneve të ndryshme sikundër është komisioni zonës së

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

administrimit zgjedhor, komisioni i qendrës së votimit apo grupet e numërimit të votave;

- afatet për partitë politike për regjistrimin si subjekte zgjedhore në këto zgjedhje;
- propozimi i kandidatve;
- afati për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore si dhe organizatave jofitimprurëse shqiptare dhe të huaja;
- si dhe publikimi i rezultatit të sondazhit të zgjedhjeve.

Për sa më lart propozojmë shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektvendimi i cili është brenda kompetencave të Komisionit Rregullator, faleminderit.

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zonja Koja. Fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit. Së pari, kemi diskutimin dhe votimin në parim të projektvendimit. Kolegë, diçka në parim për projektvendimin? Nuk ka! Kalojmë në votimin në parim.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj. Nano, z. Çela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Miratohet, me 5 vota pro!

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen apo pikë për pikë.

Në këtë fazë të procesit përveç mendimeve që mund të kenë kolegët, anëtarë të Komisionit Rregullator, pak para se të fillonte mbledhja ka ardhur një e-mail nga organizata KRIIK me disa propozime për ndryshime. Duke qenë se përfaqësuesin e organizatës KRIIK e kemi të pranishëm, në momente të caktuara do t'i japim fjalën. Në çdo rast si kësaj organizate edhe organizatave të tjera të shoqërisë civile por edhe përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore ju kemi kërkuar mundësisht të na i dërgojnë më herët. Nuk është hera e parë që dërgohen 5 minuta apo 10 minuta para mbledhjes, gjë që na vendos në vështirësi për të shqyrtuar propozimet tuaja. Gjithsesi në momentin që do t'i keni edhe pse në rregulloren e Komisionit

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

Rregullator nuk është përcaktuar kjo gjë, në momentin që do të vijmë në pikat që ju keni propozimet do tju japim fjalën për të parashtruar propozimin konkret për të cilin ne do ta diskutojmë dhe më tej do ta kalojmë në votim.

Atëherë fillojmë me pikën 1. Bashkia Kukës dhe institucionet e saj të varësisë janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën 26.08.2023 deri më datë 24.09.2023. Kemi diçka për pikën e parë? Jo! Kalojmë në votimin e pikës së parë.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj. Nano, z. Çela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)

***Kundra:*** S'ka

Miratohet, me 5 vota pro!

Ndjesë, është paragrafi i dytë, të njejtin detyrim kanë edhe institucionet publike qendrore, organet e tyre të varësisë dhe degët e tyre vendore si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore për veprimtari me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën 26.08.2023 deri më 24.09.2023 në territorin e Bashkisë Kukës ose për të. Kështu që ju ftoj ta votojmë edhe njëherë pikën 1 të plotë.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj. Nano, z. Çela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)

***Kundra:*** S'ka

Miratohet, me 5 vota pro!

Pika 2. Autoriteti i mediave audiovizive monitoron OSHMA-të për veprimtaritë me karakter publik të institucioneve publike të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, nga data 26.08.2023, nga ora 08:00 deri në orën 00:00 ose sipas rastit deri në përfundimin e programit. Kemi diçka për pikën 2 kolegë?

***Z. M. Çakaj:*** Po, ju faleminderit e nderuar. Duke qenë se ju sapo e cituat që përpara zhvillimit të kësaj mbledhje kemi marrë edhe një e-mail, pra një propozim konkret nga organizata KRIIK, unë do të kisha dëshirë, besoj është edhe këtu

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

përfaqësuesi i KRIIK-ut ta dëgjoja se çfarë konkretisht ka parashtruar përpara Komisionit Rregullator.


**Znj. I. Nano:** Një moment zoti Taulla. Patjetër zoti Çakaj, referuar e-mailit të KRIIK, propozimi është pas pikës 3 të shtohet edhe një pikë. Kështu që unë do të sugjeroja të vazhdojmë me pikën 2 dhe 3 meqenëse për pikën 2 dhe 3 nuk ka propozim KRIIK-u, apo jo? Pas pikës 3 keni propozuar?

**Z. M. Çakaj:** Po dakord, por meqë ka, të paktën fillimi i informacionit të pasqyruar në e-mail ka të bëjë së pari me veprimtarinë e OSHMA-ve dhe veprimtarinë e AMA-s dhe së dyti, më një.., të paktën organizata KRIIK si i vëmendshëm në të gjithë zgjedhjet, të paktën me një sy të shpejtë që i hodhëm informacionit të ardhur me e-mail, ka konstatuar një mungesë të kryerjes së detyrës nga AMA apo jo? Kështu që, në këtë pikë do të doja ta dëgjoja përfaqësuesin e KRIIK.

**Znj. I. Nano:** Dakord! Zoti Taulla, po!

**Z. D. Taulla:** Faleminderit. Siç thuhet edhe në e-mail ideja është që: duke qenë se nuk është e përcaktuar qartë, nuk ishte e përcaktuar që në vendimin e Komisionit Rregullator, për zgjedhjet e përsëritura të korrikut në Bashkinë Rrogozhinë, nga Autoriteti i Medias Audiovizive nuk është kryer asnjë lloj monitorimi i sjelljes së OSHMA-ve gjatë gjithë periudhës zgjedhore. Ne mendojmë që kjo është në kundërshtim me atë ç'ka fryma e ligjit parashikon. Përtej faktit që Kodi Zgjedhor nuk thotë specifikisht për zgjedhje të përsëritura apo për zgjedhje të pjesshme si në rastin konkret. Ne mendojmë që sjellja e OSHMA-ve duhet të monitorohet dhe i takon Komisionit Rregullator që të vendosë një përcaktim që AMA ka detyrimin që të monitorojë sjelljen dhe

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

mbulimin e OSHMA-ve njëlloj si në zgjedhjet e zakonshme. Pra, kjo është logjika e propozimit tonë.

**Znj. I. Nano:** Atëherë, bëhet fjalë për monitorimin e OSHMA-ve në raport me veprimtaritë me karakter publik apo për monitorimin e OSHMA-ve në raport me fushatën zgjedhore?

**Z. D. Taulla:** Për monitorimin në raport me fushatën zgjedhore, specifikisht. Jo për monitorimin...

**Znj. I. Nano:** Dakord! Prandaj them sepse monitorimi i OSHMA-ve ka një fushë më të gjerë se sa kaq. Nëqoftëse ju keni monitoruar AMA-n dhe keni vlerësuar që nuk ka monitoruar OSHMA-të gjatë fushatës zgjedhore, personalish mendoj që detyrimi i AMA-s i buron drejtpërdrejtë nga Kodi Zgjedhor. Në nenin 85, pika 1, thuhet “Monitorimi i fushatës zgjedhore në media kryhet nga enti rregullator që rregullon dhe mbikëqyr fushën e shërbimeve, transmetimeve audio dhe audiovizive. Monitorimi kryhet në të gjithë territorin ku zhvillohen zgjedhjet”. Atëherë, detyrimi i AMA-s buron pikërisht nga neni 85/1. Nëqoftëse një institucion qoftë ky AMA, qoftë KQZ-ja nuk përmbushin detyrimet ligjore është diçka tjetër. Ne në këtë akt, unë po bëj një sqarim personal pastaj e diskutojmë përsëri, miratojmë kohën kur fillon fushata zgjedhore. Disa pika më vonë në këtë projektvendim kemi datën e fillimit të fushatës. Pra, fushata monitorohet nga AMA, data e fillimit të fushatës caktohet në këtë vendim. Kush do të ishte propozimi juaj konkret?! Sepse ne kemi edhe një akt që lidhet me..., është miratuar për zgjedhjet e vitit 2021, është ndryshuar në vitin 2022 pikërisht për zgjedhje të pjesshme që është metodologjia e monitorimit të AMA-s. Ku mendoni ju se duhet të ndërhyjmë? Te metodologjia? Ka diçka që nuk shkon te metodologjia?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

**Z. D. Taulla:** Atëherë, konkretisht ne i referohemi edhe përgjigjes që AMA i ka dhënë KRIIK-ut në përgjigje të pyetjes “nëse ka monitoruar sjelljen e OSHMA-ve për zgjedhjet e korrikut”. Specifikisht nuk do të doja ta lexoja, e keni të cituar tek e-maili. Në thelb AMA justifikohet duke thënë që kjo nuk është kryer, nuk ka dërguar raporte ditore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve pasi nga Komisioni Rregullator, nga KQZ-ja nuk i ka ardhur asnjë kërkesë e tillë. Kështu që në këtë rast duke qenë që ekziston si të thuash ky keqkuptim...

**Znj. I. Nano:** Ju si organizatë kur bëni këtë vlerësim mund të shkoni më përtej sesa vetëm komunikimi me AMA-n. Pra, ju na vini para faktit që nuk është kryer monitorim dhe AMA thotë s’na ka dërguar KQZ-ja diçka. Pikërisht si një “*watch dog*” që e tha edhe kolegu më herët. Mendoni që kjo buron se nuk i ka dërguar KQZ-ja ndonjë rregullim, apo sepse nuk kanë zbatuar Kodin Zgjedhor?

**Z. D. Taulla:** Ne nuk i hyjmë asaj pjese.

**Znj. I. Nano:** Ju patjetër do ti hyni asaj pjese, sepse ju keni ardhur me një propozim këtu dhe ky propozim vjen mbasi keni studiuar një situatë të tërë. Atëherë pyetja ime për ju, para se të kaloj për diskutim, ju mendoni që AMA ka patur mangësi në akte ligjore për ta monitoruar fushatën?

**Z. D. Taulla:** Vlerësimi i punës së AMA-s apo i institucioneve të tjera nga ana e KRIIK bëhet në deklaratat tona paraprake dhe në raportet tona dhe ne tani e kemi bërë këtë. Në deklaratën tonë paraprake ne e kemi bërë. Detyra jonë si “*watch dog*” është që të identifikojmë problematikat, t’i bëjmë publike ashtu si dhe të sjellim propozime aty si ne gjykojmë, apo aty ku ne gjykojmë që mund të përmirësohet. Në gjykimin tonë duke qenë që në rastin e korrikut dhe vlerësimi është bërë, në deklaratën paraprake për të...

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**Znj. I. Nano:** Nuk është vlerësim, është fakt që AMA nuk ka monitoruar dhe s'ka dorëzuar raporte thoni ju.

**Z. D. Taulla:** Kjo është përgjigjja e AMA-s, nuk e themi ne, e thotë AMA.

**Znj. I. Nano:** Po pra, dhe ju merrni përgjigjen e AMA-s si të mirëqenë dhe e sillni këtu si problematikë. Atëherë, vlerësimi juaj si organizatë ku ka çaluar? Ku qëndron problematika? Që nëse qëndron tek ne ta rregullojmë ne, nëse qëndron tek AMA, ta rregullojë AMA.

**Z. D. Taulla:** Ne kemi një propozim konkret i cili ka ardhur me e-mail, të cilit nuk është se kam për ti shtuar diçka.

**Znj. I. Nano:** Atëherë edhe njëherë, unë ju thash e-mailin ne e kemi parë që na ka ardhur 10 minuta para mbledhjes dhe prandaj është rasti që jeni këtu dhe mund të na i shpjegoni. Pra, pyetja ime për të cilën nuk mora përgjigje, ku qëndron problematika? Sipas jush, sepse jeni ju që po na e propozoni këtë ndryshim. Problematika qëndron se s'ka raportuar AMA? AMA nuk ka monitoruar dhe s'ka raportuar, sepse s'ka pasur ku të bazohet ligjërisht? Apo mendoni një problematikë tjetër?

**Z. D. Taulla:** Nëse mundem vetëm një përgjigje pa dashur ta kthejmë në debat. Projektpropozimi na ka ardhur sot në mëngjes rreth orës 10 të mëngjesit dhe besoj se në kohë rekord kemi ardhur me rekomandime, besoj. Në lidhje me ato ç'ka ne kemi sjellë edhe njëherë, ne kemi një gjykim. Ne gjykojmë se duke qenë që AMA ka thënë që "mua nuk me ka ardhur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve një kërkesë përmbi këtë" mendojmë se Komisioni Rregullator apo KQZ-ja duhet t'i



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

drejtohet AMA-s se si konkretisht, ligjërisht, sigurisht që kjo është detyra juaj dhe jo jona. Ne sjellim një propozim. Pra, në gjykimin tonë mund të vendoset një pikë 3/1 siç është e thënë në e-mailin zyrtar të dërguar ku ti kërkohet AMA-s specifikisht që të monitorojë sjelljen e OSHMA-ve gjatë fushatës zgjedhore sipas detyrimit ligjor, duke qenë se nuk e ka bërë. Se mund të bëhet me këtë, se mund të bëhet me mënyrë tjetër sigurisht që është vendimi juaj, absolutisht nuk është pjesë e jona për ta... ne kemi sjellë thjesht një propozim.


**Znj. I. Nano:** Po, zoti Çakaj.

**Z. M. Çakaj:** Atëherë, me sa kuptoj gjithë problemi që... ajo çfarë s'kuptoj është pse po i vini vërdallë problemit?! Ndërkohë mund të thoni troç që Komisioni Rregullator nuk ka miratuar atë vendim të cilin në vendimin numër 7 "Për disa shtesa dhe ndryshime të vendimit numër 2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator "Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive", parashikohet që pika 4, e nenit 5 të riformulohet si më poshtë: "Për zgjedhjet e parakohshme dhe/ose të pjesshme, afati për monitorimin e veprimtarive të institucioneve publike përcaktohet me akt normativ të posaçëm të Komisionit Rregullator". Tani, së pari, kalojmë te problemi kryesor, te problemi nga buron komunikimi juaj me AMA-n...

**Znj. I. Nano:** Ndjesë zoti Çakaj, thatë për monitorimin e veprimtarive të institucioneve publike? S'jemi te fushata!?

**Z. M. Çakaj:** Po dakord, por problemi kryesor ka ardhur që këtu, sepse këtu për sa kohë ne kemi parashikuar zgjedhje të parakohshme dhe/ose të pjesshme, do të duhet të paktën, nuk e gjej këtu, edhe zgjedhjet e ripërsëritura. Pra, të parashikohet këtu, së pari. Së dyti, në rastin konkret unë besoj se shqetësimi juaj

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

është i zgjidhur, sepse pikë së pari AMA-s i buron detyrimi për të monitoruar këto nga Kodi Zgjedhor. Së dyti, i buron nga vendimi numër 2 i Komisionit Rregullator “Për miratimin e metodologjisë...” dhe shqetësimi juaj është pasqyruar dhe në pikën 2, dhe më pas akoma. Së pari, kur kemi përcaktuar datën e fillimit të fushatës zgjedhore dhe automatikisht me identifikimin e datës së fillimit të fushatës zgjedhore detyrimi ligjor i AMA-s do të aktivizohet, do të vihet automatikisht në funksion. Kështu që nëse AMA e kryen apo jo detyrën kjo është një çështje tjetër, por sigurisht faleminderit që na sillni të gjitha këto shqetësime tuaja, por unë mendoj se propozimi juaj konkret në rastin konkret gjen zgjidhje në miratimin e këtij akti. Ndërsa për sa i përket atyre të tjerave është çështje e Komisionit Rregullator të shohë, të ndryshojë apo të hamendësojë aktet e tij. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Çakaj. Po Zoti Çaka!

**Z. D. Çaka:** Faleminderit e nderuar kryetare. Do të vlerësoja që..., po themi që konstatimi nga përfaqësuesit e KRIIK-ut, referuar dhe përgjigjes së dhënë nga AMA, që Komisioni Rregullator nuk ka pas përcaktuar, ose Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka pas përcaktuar një afat për monitorimin e OSHMA-ve në fushatën zgjedhore të zhvilluar për ripërsëritjen e korrikut në Rrogozhinë. Duhet theksuar që në vlerësimin tim personal, Komisioni Rregullator ka qenë shterrues në vendimmarrjen e marrë në korrik të këtij viti. Kodi Zgjedhor ka përcaktuar një detyrim për monitorimin e OSHMA-ve nga AMA vetëm gjatë fushatës zgjedhore. Nuk mundet Komisioni Rregullator të dalë përtej përcaktimeve të Kodit Zgjedhor. Në zgjedhjet e ripërsëritura nuk ka pasur një afat për fushatë të re zgjedhore. Nuk mundet Komisioni Rregullator apo çdo strukturë tjetër që të përcaktojë një fushatë. Fushata zgjedhore për zgjedhjet e ripërsëritura në Rrogozhinë ka qenë ajo e përcaktuar në Kodin Zgjedhor, në akte të Rregullatorit

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

që janë bërë për datën 14 maj të këtij viti. Pra, në zgjedhjet e ripërsëritura të Rrogozhinës nuk ka pasur fushatë zgjedhore, nuk ka pasur në aktin e Komisionit Rregullator të përcaktuar një gjë të tillë, sepse kemi ripërsëritje të zgjedhjeve nuk është një fushatë zgjedhore. Në këto kushte vlerësoj se, Komisioni Rregullator në këto momente nuk kishte pse të përcaktonte një afat edhe për AMA-n për monitorimin e OSHMA-ve. Ndërsa përsa i përket pjesës tjetër të propozimit tuaj bie dakord me kolegun Çakaj që, shqetësimi juaj në këtë rast është i zgjidhur në momentin që ne kemi përcaktuar një afat kur fillon fushata zgjedhore për këto zgjedhje dhe burimi kryesor i detyrimit nga të cilën e ka AMA, e ka Kodi Zgjedhor. Në momentin që thotë që ky afat fillon në momentin e fushatës zgjedhore kjo gjen zgjidhje në vlerësimin tim, faleminderit.

**Znj. I. Nano:** Zonja Vukaj, po!

**Znj. H. Vukaj:** Personalisht e falenderoj zotërinë përfaqësues të KRIIK-ut, për panoramën që solli. Në logjikën e asaj që solli është me vlerë ta marrim në konsideratë, sepse ky konstatim dhe me sa kërkon zotëria, konsiston të jetë pjesë e sigurisë, e rritjes së cilësisë së këtyre zgjedhjeve. Pra, të zgjedhjeve në Kukës. Në qoftë se AMA nuk është në gjendje.., kjo është pyetje më pas retorike dhe shoqëruese, që të zbatojë kodin, nuk e sheh kodin dhe ky konstatim u bë në zgjedhjet e Rrogozhinës, a do ta lejonim përsëri AMA-n të nxirrte të njëjtin justifikim dhe të konstatohej përsëri në Kukës? Për një mospërfshirje të këtij propozimi në këtë akt? Ndoshta nuk është akti i duhur, duhet të ishte në akte të tjera. Sigurisht qëndron dhe argumenti që kodi e ka të qartë detyrën që i ngarkon AMA-s. A do të ishte e mangët mungesa e papërfshirjes së këtij propozimi për rritjen e cilësisë së këtyre zgjedhjeve? Faleminderit! Unë do të doja të dëgjoja propozimin tuaj zotëri përfaqësues i KRIIK!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

**Znj. I. Nano:** Po zoti Taulla!

**Z. D. Taulla:** Propozimi im është ai që është në e-mail...

**Znj. I. Nano:** Nuk kemi arritur ta lexojmë plotësisht. Mundet ta lexoni tani propozimin? Propozim konkret, ai që është në e-mail... propozim konkret që ne ta kalojmë për votim?

**Z. M. Çaka:** Më fal, ju e gjeni me vend të pasqyruar shqetësimin tuaj në draftimin e këtij akti që kemi përpara sot? E gjeni të pasqyruar?


**Z. D. Taulla:** Edhe njëherë, shqetësimi ynë lind.., nuk po hyjmë në detaje, teknikalitete dhe në propozime konkrete në këtë rast. Shqetësimi ynë është shqetësimi i një organizate “*watch dog*” dhe shqetësimi ynë është madhor. OSHMA-të nuk u monitoruan...

**Znj. I. Nano:** Nuk kishte fushatë zgjedhore.

**Z. D. Taulla:** AMA tha që “unë nuk kam pasur një kërkesë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”. Ky shqetësim ne gjujkojmë që mund të zgjidhet. Në këtë akt, në një mënyrë tjetër, sigurisht që i takon institucioneve kompetente. Në rastin konkret KQZ, Komisionit Rregullator, Komisionerit, sigurisht është vendimi juaj. Nëse ju e shihni si shqetësim. Një propozim konkret të formuluar se si mund të përfshihet në këtë akt, në këtë moment, unë nuk e kam.

**Z. M. Çakaj:** Një moment që ta qartësojmë. Në zgjedhjet e ripërsëritura të Rrogozhinës, meqenëse Kodi Zgjedhor nuk parashikon caktimin e një date zgjedhore, ndoshta nuk ka funksionuar automatikisht sistemi dhe detyrimi i

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

AMA-s për ta ashtu... megjithatë, unë personalisht bie dakord me ju, që pavarësisht se nuk kemi përcaktuar një datë për fushatë dhe një periudhë për fushatë zgjedhore, detyrimi i AMA-s do të duhej se s'bën nëse jo nga kodi, të përcaktohej me akt të Komisionit Rregullator. Unë personalisht bie 100 % dakord me ju në ato zgjedhje. Megjithatë këto zgjedhje që do të zhvillohen në Kukës këto kanë një natyrë tjetër. Këto janë zgjedhje të pjesshme vendore, nuk janë zgjedhje të përsëritura. Kështu që në këtë kontekst, shqetësimi juaj pavarësisht se duhet të ndahet për zgjedhjet e kaluara dhe për zgjedhjet që po vijnë. Për zgjedhjet e Rrogozhinës, unë e gjej me vend shqetësimin tuaj, për këto që po vijnë, a gjeni të pasqyruar 100 % në draftin tonë shqetësimin tuaj?

**Z. D. Taulla:** Fushata zgjedhore për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë fillon në datë 10 korrik. Ka pasur një periudhë fushate zgjedhore në aktin e miratuar nga ju...

**Znj. I. Nano:** S'ka përmbushur AMA detyrimin e saj që i buron nga ligji.

**Z. D. Taulla:** Po, po dakord! Nuk po diskutoj atë, thjesht ajo që ne do të sillnim si propozim konkret "monitorimi i fushatës zgjedhore prej Autoritetit të Mediave Audiovizive, fillon në datën 11.09.2023", pika 3/1, kaq e thjeshtë mund të jetë. Ky do të ishte një propozim konkret.

**Znj. H. Vukaj:** Meqenëse ju konstaton, për të arritur një qëllim të caktuar, i cili konsiston të jetë rritja e cilësisë dhe përmbushja e parimit të ligjshmërisë së këtyre zgjedhjeve, atëherë patjetër duhet të kishit një propozim dhe mirë se erdhi, propozimi.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

**Znj. I. Nano:** Faleminderit! Kalojmë në votimin e propozimit të pikës 2 në të cilën nuk ka propozime?

**Kush është dakord kolegë me pikën 2 të projektvendimit?**

**Pro:** 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, Znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Kundër:** S'ka!

Miratohet me pesë vota pro!

Kalojmë në pikën tre, po lexoj “Fushata zgjedhore për zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar bashkie në Bashkinë Kukës, fillon më datë 11.9.2023”.

Kemi diçka për fushatën? Jo!

Kalojmë në votimin e pikës 3.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Kundër:** S'ka!

Miratohet me pesë vota pro!

Kemi një propozim për të shtuar një pikë 3/1 sipas KRIIK-ut, “Autoriteti i Mediave Audiovizive, monitoron OSHMA-të gjatë fushatës zgjedhore, duke filluar nga data 11.09.2023”. Jam korrekt me propozimin tuaj?

**Kush është dakord?**

**Pro:** 2 (znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Kundër:** 3 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela)

Më duhet të shpjegoj votën kundër. Më duket një dispozitë parazitare, për shkak se ne themi fillon fushata në datën 11.09.2023, aktivizohen të gjitha detyrimet, në këtë rast dhe të AMA-s nga 85/1. Pra, edhe duke mos e vendosur këtë detyrim ne këtu, AMA ka detyrimin ligjor. Pra, nëse nuk përmbush AMA detyrimet ligjore, nuk është në dorën e KQZ-së në përgjithsi, apo të Rregullatorit në veçanti, që të vendosë pa fund rregulla kur nuk zbatohet ligji drejt për së drejti.. është ligj i drejtpërdrejtë.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

Kalojmë në pikën 4. “Zyra e Gjendjes Civile në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, hartojnë listat e zgjedhësve jo më vonë se data 16.08.2023. Brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga përfundimi i përditësimit, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore miraton dhe shpall listat e zgjedhësve, në përputhje me nenin 48 të Kodit Zgjedhor”.

Për këtë pikë, unë personalisht kam një propozim. Edhe këtu kemi të bëjmë me disa afate ligjore. Mendoj se nuk do të ishte mirë të vendosnim datë në këtë rast, sepse “jo më vonë se data 16.08..” është edhe data 15 dje dhe data 14 pardje. Kështu që mendoj ta vendosim si një dispozitë referuese duke ju referuar nenit 59 të Kodit Zgjedhor i cili flet për listën e zgjedhësve të zgjedhjeve të pjesshme, të parakohshme, apo të përsëritura. Në rastin e zgjedhjeve të pjesshme, të parakohshme dhe jemi në këto kushte. Jo më vonë se pesë ditë nga nxjerrja e dekretit, zyrat e gjendjes civile në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile hartojnë listat e zgjedhësve. Pra, në datë 11 është dekretuar data e zgjedhjeve, është data 16 në fakt, është data e sotme, por bëhet fjalë për një situatë që edhe mund të jenë miratuar listat dje. Kështu që sikundër kemi më poshtë në fjalinë e dytë, referencën në nenin 48 të Kodit Zgjedhor, personalisht do të propozoja që edhe këtu të kemi referencën në nenin 59 të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu edhe një diskutim kolegë. Referuar kodit, ne flasim për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore. Më tej flasim për “kryetarë bashkie”, “kryetarë bashkie” dhe në pikën 17 themi “kryetari i bashkisë në detyrë”. Unë do të propozoja që të kemi një harmonizim, sepse aktualisht kemi një kryetar bashkie në detyrë, jo një kryetar bashkie të zgjedhur. Kjo që, të vlerësohet gjatë zbardhjes nëse... s’kemi kryetarë bashkie sot në Kukës?

**Z. M. Çakaj:** Po pra, kryetari i bashkisë është në burg sot...

**Znj. I. Nano:** Kemi kryetar bashkie në detyrë.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

**Z. M. Çakaj:** Kemi një kryetar bashkie në detyrë se ish kryetari i bashkisë...

**Znj. I. Nano:** Ish, pra ju thatë “ish”, pra aktualisht kemi kryetar bashkie në detyrë.

**Z. M. Çakaj:** Po, sepse aktualisht ai ndodhet në burg.

**Znj. I. Nano:** Pra, kemi kryetar bashkie në detyrë dhe unë mendoj që gjatë aktit ta harmonizojmë këtë shprehje. Pra, propozimi im për pikën 4 është që të mos vendosim datë, por të vendosim referencën në nenin 59 të Kodit Zgjedhor. Propozim tjetër? Po zonja Vukaj!

**Znj. H. Vukaj:** Një pyetje në lidhje me administratën. Do të doja të dija në ç’kushte ndodhet kjo marrëdhënia mes Zyrës së Gjendjes Civile me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në raport me listat e zgjedhëve. Kemi ndonjë informacion?

**Znj. M. Koja:** Informacion nuk kemi për momentin, por jua vemë në dispozicion, mund të pyesim.

**Znj. H. Vukaj:** Jo, ideja është që do të donim ta lidhnim me propozimin e koleges, apo të mbetemi në një afat strikt...

**Znj. M. Koja:** Edhe afati 5-ditor është një afat që buron nga kodi sikundër e tha dhe zonja Nano.

**Znj. H. Vukaj:** Sigurisht, sigurisht se përlllogaritje...



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

**Znj. M. Koja:** Thjesht e kemi evidentuar datën se kur përfundon, deri më datë 16 nuk është se ky detyron zyrat e gjendjes civile të veprojnë në rastin konkret. Informacionin për sa ju më kërkuat, unë nuk e kam.

**Znj. I. Nano:** Propozim tjetër, diskutim tjetër për pikën 4? Kur themi jo më vonë se data 16 është një gjë që mund të ketë ndodhur edhe dje. “Jo më vonë” do të thotë 16 dhe më herët.

**Znj. H. Vukaj:** Problemi është se mos cedojnë me datën 16...

**Znj. I. Nano:** Përsëri detyrimi i tyre është se dhe ky buron drejtpërdrejtë nga kodi.

**Znj. H. Vukaj:** Ekspozimi i datës dhe bërja me dije e datës i shtrëngon ta respektojnë...

**Znj. I. Nano:** Sot është data 16...

**Znj. H. Vukaj:** Ata duhet ta kishin sjellë...

**Znj. I. Nano:** Po pra dhe ne nuk e dimë, edhe mund ta kenë respektuar dhe ne nuk e dimë këtë gjë. Mund ta kenë bërë dje, mund ta kenë bërë pardje.

**Znj. H. Vukaj:** Aq më mirë për ta në qoftë se e kanë bërë dje, puna është të mos e bëjnë nesër.

**Znj. I. Nano:** Përsëri është çështje e përmbushjes së detyrimit të tyre dhe e theksoj dhe njëherë “detyrimi për hartimin e listës së zgjedhësve nuk i buron nga akti i Rregullatorit, i buron drejtpërdrejtë nga ligji. Megjithatë për mua nuk ka asnjë

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

problem. Unë do ta quaja lapsus edhe parazitare këtë dispozitë kur detyrimi i një institucioni tjetër buron drejtpërdrejtë nga ligji.

**Znj. H. Vukaj:** Megjithatë është një çështje sensitive çështja e listave, kështu që këtu jemi fiks te akti i afateve proceduriale, kështu që zë vend.


**Znj. I. Nano:** Patjetër, patjetër është një diskutim i bërë dhe më herët. Ka disa afate që burojnë drejtpërdrejtë nga kodi. Kjo do të thotë që i shkruajmë, apo nuk i shkruajmë, i miratojmë, apo nuk i miratojmë ne këtu, ato burojnë nga kodi. Ne pikërisht për këtë arsye miratojmë afate proceduriale në rastin e zgjedhjeve të parakohshme, në rastin e zgjedhjeve të pjeshme, në rastin e përsëritjes së zgjedhjeve, pikërisht për faktin që kodi ka disa afate të tjera që lidhen me zgjedhjet normale.

**Z. M. Çakaj:** Më fal, dakord zonja Kryetare, por ne nuk do të rrimë vetëm në nivel teorik këtu. Ajo çfarë ne miratojmë si akt do të duhet, meqenëse jemi dhe pjesë e institucionit të ngarkuar me ligj për administrimin e zgjedhjeve, do të duhet të kemi dhe një informacion konkret. Në ç'fazë jemi me hartimin e listave për zgjedhjet...

**Znj. I. Nano:** Unë propozoj ndërprerjen e mbledhjes dhe të marrim një informacion dhe vazhdojmë.

**Z. M. Çakaj:** Le të marrim një informacion nga personat përgjegjës në KQZ të cilët le të marrin kontakt dhe ne ose vendosim datën 16, ose vemë “në përputhje me parashikimet e nenit 59”, përsëri data 16 i bie, por nuk e shprehim. Por të paktën të kemi informacion dhe të na e bëjmë me dije së pari ne, dhe së dyti publikut, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**Znj. I. Nano:** Dakord! Bëjmë një ndërprerje të mbledhjes, marrim një informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile deri në momentin që flasim, që jemi brenda afatit ligjor është hartuar lista e zgjedhësve sipas nenit 59, faleminderit!

**Rifillon mbledhja**

**Ora13:55**

**Znj. I. Nano:** Rifillojmë mbledhjen. Morët ndonjë informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ose Zyra e Gjendjes Civile e Bashkisë Kukës?

**Znj. M. Koj:** Nga sa arrita të marr informacion, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shkresërisht në datën 15, pra ditën e djeshme, i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile të verë në dispozicion të KQZ-së ekstraktin e zgjedhësve për Bashkinë Kukës. Në përfundim të afateve do të marrim përgjigjen. Deri më tani, verifikuam dhe në protokoll, nuk ka ardhur ende përgjigja.

**Znj. I. Nano:** Po, atëherë kolegë, si mendoni pasi kërkuat këtë informacion?

**Z. M. Çakaj:** Mendojmë dhe shpresojmë që kryetari në detyrë i Bashkisë Kukës të zbatojë detyrimet e Kodit Zgjedhor.

**Znj. I. Nano:** Që i burojnë “48 orë pas datës së sotme”.

**Z. M. Çakaj:** Po pra, po informacionin duhet ta kishte paraqitur, a është data e fundit sot për hartimin e listave të zgjedhësve?

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

**Znj. M. Koja:** Ai deri më sot ka afatin për t'i hartuar, pastaj kur ja njofton KQZ-së nuk ka një afat të përcaktuar. Ne e kemi kërkuar që ditën e djeshme. Pra, me përfundimin e afatit ligjor që është sot, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile do t'i japë një kopje të ekstraktit së bashku me raportet statistikore përkatëse dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Z. M. Çakaj:** Dakord, po çfarë ndodh në qoftë se nuk e jep këtë informacion KQZ-së? Meqenëse nuk ka një afat nga Kodi Zgjedhor.

**Znj. M. Koja:** Deri më sot nuk e kemi një praktikë të tillë. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile e ka dërguar gjithmonë KQZ-së ekstraktin e listës së zgjedhësve.

**Z. M. Çakaj:** Dakord!

**Znj. I. Nano:** Atëherë për përmbajtjen e pikës 4, kemi ndonjë diskutim?

**Z. M. Çakaj:** Sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor.

**Znj. I. Nano:** Pra, sipas atij propozimi që unë bëra në përputhje me nenin 59?

**Znj. H. Vukaj:** Jo, jo unë jam për datën 16.08, sepse nuk kemi garanci për listat. Propozimi i koleges është korrekt, por me situatën...

**Znj. I. Nano:** Pra, sipas Kodit Zgjedhor mbetet detyrimi i kodit, jo detyrim i vendosur nga ne. E tërheq propozimin tim për referencën në Kodin Zgjedhor dhe lemë datën 16 që në fakt është derivat i llogaritjes që buron Kodi Zgjedhor. Pa

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

dysim që kjo që ne po vendosim nuk është një normë e re por një afirmim i një norme që buron nga Kodi Zgjedhor. Kalojmë në votimin e pikës 4.

***Kush është dakord siç është hartuar?***

***Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, Znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)***

***Kundër: S'ka!***

Miratohet me pesë vota pro!

Pika 5. Partitë politike të cilat kanë të drejtë të paraqesin anëtarë/sekretar në KZAZ-në nr. 11, të Bashkisë Kukës, Qarku Kukës, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, duhet të sjellin propozimet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, jo më vonë se data 18.8.2023. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton përbërjen e KZAZ-së jo më vonë se data 21.8.2023. kemi diçka për këto afate? Jo! kalojmë në votimin e pikës 5.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, Znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)***

***Kundër: S'ka!***

Miratohet me pesë vota pro!

Pika 6. Partitë politike të cilat kanë të drejtë të paraqesin anëtarë në KQV, duhet t'i depozitojnë ato në KZAZ-në përkatëse, jo më vonë se data 1.09.2023. KZAZ-ja merr vendim për emërimin e anëtarëve të KQV-ve, jo më vonë se data 4.09.2023.

Për pikën 6, për anëtarët e KQV-ve? Nuk ka diçka! Kalojmë në votimin e pikës 6.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, Znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)***

***Kundër: S'ka!***

Miratohet me pesë vota pro!

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

Pika 7. Partitë politike të cilat kanë të drejtë të paraqesin anëtarë në GNV duhet t'i depozitojnë ato në KZAZ, jo më vonë se data 12.09.2023. KZAZ-ja merr vendim për emërimin e anëtarëve të GNV-ve, jo më vonë se data 14.09.2023.

Për pikën 7, për këto afate? Nuk kemi ndonjë propozim, kalojmë në votim!

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, Znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)***

***Kundër: S'ka!***

Miratohet me pesë vota pro!

Pika 8. Partitë politike duhet të paraqesin kërkesën në KQZ për regjistrim si subjekte zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Kukës, jo më vonë se data 1.09.2023. KQZ-ja kthen për plotësim dokumentacionin brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga dorëzimi. Partitë politike paraqesin dokumentacionin e korigjuar brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga kthimi për plotësim. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton kërkesat për regjistrim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga ridërgimi i dokumentacionit.

Kemi diçka kolegë për pikën 8? Kalojmë në votim!

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, Znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)***

***Kundër: S'ka!***

Miratohet me pesë vota pro!

Pika 9. Komitetet Nismëtare duhet të paraqesin kërkesën për regjistrim për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Kukës, në KZAZ-në nr.11, jo më vonë se data 1.09.2023. KZAZ-ja kthen për plotësim dokumentacionin brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga dorëzimi. Komitetet Nismëtare paraqesin dokumentacionin e korigjuar brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga kthimi për plotësim. KZAZ-ja miraton kërkesat për regjistrim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga ridërgimi i dokumentacionit.

Diçka për pikën 9? Nuk ka! Kalojmë në votimin e pikës 9!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



***Kolegë, kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, Znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)***

***Kundër: S'ka!***

Miratohet me pesë vota pro!

Pika 10. Koalicionet zgjedhore duhet të paraqesin në KQZ kërkesën për regjistrimin si koalicion për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Kukës jo më vonë se data 6.09.2023. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton kërkesën për regjistrimin si koalicion, brenda 24 (njëzet e katër) orëve.

Keni për pikën 10 ndonjë diskutim, për këto afate? Jo! Kalojmë në votim!

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, Znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)***

***Kundër: S'ka!***

Miratohet me pesë vota pro!

Pika 11. Dokumentet e kandidimit paraqiten në KZAZ-në nr.11, jo më vonë se data 8.09.2023. KZAZ-ja bën verifikimin e tyre jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga paraqitja dhe në rast se vëren parregullsi, i kthen për plotësim. Dokumentet e plotësuara duhet të riparaqiten jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë. KZAZ-ja merr vendim jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga riparaqitja e tyre.

Për pikën 11, dokumentet e kandidimit? S'ka diskutime!

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, Znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)***

***Kundër: S'ka!***

Miratohet me pesë vota pro!

Pika 12. Paraqitja e kërkesës për akreditimin e vëzhguesve shqiptarë dhe për vëzhguesit e huaj bëhet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve jo më vonë se data 22.09.2023. Edhe për këtë çështje KRIIK-u kishte në e-mailin e tij diçka? Po!

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

**Z. D. Taulla:** Faleminderit zonja Kryetare! Propozimi i KRIIK-ut është thjesht në linjë me vendimmarrjen që ka pasur Rregullatori për zgjedhjet e korrikut të Rrogozhinës dhe për zgjedhjet e marsit të vitit 2022. Kjo që të jetë pesë ditë dhe jo dy ditë, pasi dy ditë thjesht është vetëm dita e shtunë, sepse i bie në datën 22 deri në orën 12 të natës. Nëse një organizatë nuk akreditohet, nuk ka afate të ankimohej, pra s'ka kohë për ankimim praktikisht. Ne propozojmë të jetë pesë ditë siç është praktika e Rregullatorit.

**Znj. I. Nano:** Për një interpretim gjuhësor dhe teknik të normës së propozuar. “jo më vonë se data 22”. Kjo do të thotë më herët se data 22 mund të paraqitet. Pra, i është lënë një afat pak më shumë për akreditimin.

**Z. D. Taulla:** Absolutisht dakord! Në gjykimin tonë duhet të jenë pesë ditë dhe jo dy ditë, për arsye se është shumë afër ditës së zgjedhjeve, për arsye se e vendos në ditët e fundit.

**Znj. I. Nano:** Të mos e lerë për ditën e fundit. Pra, “jo më vonë se data...!”, i shtohet koha! Po të thoshim “jo më vonë se se data 19”, pesë ditët e fundit humbiste mundësia për të propozuar. Pra, këtu është shtuar dhe pak afati, koha që i lihet në dispozicion për akreditim vëzhguesve shqiptarë. Pra, shprehja “jo më vonë se..”, vendos si afat maksimal 22. Pra 21, 20, 19 e kur të duan më përpara. Atëherë kolegë, kalojmë në votimin e pikës 12?

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, Znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Kundër:** S'ka!

Miratohet me pesë vota pro!

E njejta gjë edhe për akreditimin e subjekteve zgjedhore.

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

Pika 13. Paraqitja e kërkesave për akreditim nga ana e subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhje bëhet në KZAZ-në nr. 11 jo më vonë se data 22.09.2023.


**Z. D. Taulla:** Sërish, por këtu kemi një argument shumë më të fortë. Praktikisht nuk ka kontroll mbi.. në Rrogozhinë, po ju sjell rastin e Rrogozhinës. Deri në afatin zyrtar nuk kishte ardhur asnjë kërkesë, konfirmuar nga KZAZ-ja, nuk ka pasur asnjë vendim formal për akreditim vëzhguesish, por vëzhguesit tanë panë pafundësisht vëzhgues politikë. Vëzhguesit politikë kanë nevojë të disiplinohen. Vendimmarrja e KZAZ-së duhet të vijë brenda 24-orëve në KQZ sipas ligjit. Në gjykimin tonë, vetëm një ditë praktikisht do t'i lerë zero kontroll KZAZ-së mbi vëzhguesit politikë dhe do të ketë mundësi kushdo të marrë një kartë identifikimi. Kjo është një situatë që ne e vumë re në zgjedhjet e Rrogozhinës.

**Znj. I. Nano:** Sa më shumë vëzhgues, aq më mirë! Çfarë problemi ka për vëzhguesit? Ju doni që ta shtyjme afatin ta çojmë 23, apo ta tërheqim?

**Z. D. Taulla:** Afati të jetë sipas praktikës që ka pas Rregullatori në zgjedhjet e mëparshme, pesë ditë përpara. Ky është arësyetimi ynë, sepse vëzhgues më shumë mund të jenë, por të mos harrojmë se përgjatë numërimit shumë shpesh kanë qenë problematikë vëzhguesit e tepërt të cilët hyjnë vend e pavend. Policia nuk ka mundësi që t'i kontrollojë. Ndërpritet numërimi, nxirren jashtë, rikthehen. Ke njerëz që vijnë vërdallë, pa karta akreditimi por me çopa letre. Ka nevojë për disiplinim. Fenomeni është shumë më i madh se kaq.

**Znj. I. Nano:** Ka dhe akte të tjera të Rregullatorit që rregullojnë praninë e personave në vendin e numërimit të votave.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

**Z. D. Taulla:** Ne mendojmë që KZAZ-së ti mbetet kjo, por praktikisht vetë KZAZ-ja merret me shpërndarjen e materialeve zgjedhore dhe shumë gjëra të tjera dhe do të...

**Znj. I. Nano:** “..deri ditën e premte...”, nuk ka filluar shpërndarja e materialeve. Është një afat më tepër që u lihet, më shumë.

Kolegë, kemi diçka për pikën 13? Kalojmë në votim?

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, Znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Kundër:** S’ka!

Miratohet me pesë vota pro!

Pika 14. Kryetari i bashkisë në detyrë, paraqet në KQZ listën e plotë të objekteve të qendrave të votimit që përmbushin kushtet e parashikuara në ligj, jo më vonë se data 27.08.2023.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, Znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Kundër:** S’ka!

Miratohet me pesë vota pro!

Pika 15. Prefekti i Qarkut Kukës i paraqet KQZ-së listën e plotë të objekteve brenda territorit të Qarkut që përmbushin kushtet e parashikuara në ligj për vendin e numërimit të votave, jo më vonë se data 27.08.2023.

Me këtë afat keni ndonjë diskutim?

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, Znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Kundër:** S’ka!

Miratohet me pesë vota pro!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

Pika 16. Rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë 3 (tre) ditëve të fundit para datës së zgjedhjeve, përfshirë edhe datën e zgjedhjeve deri në orën e mbylljes së votimit.

Kemi diçka lidhur me pikën 16? Nëse jo kalojmë në votim!

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, Znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)***

***Kundër: S'ka!***

Miratohet me pesë vota pro!

Pika 17. Kryetari i bashkisë në detyrë të përcaktojë vendet publike në territorin e bashkisë Kukës për afishimin nga subjektet zgjedhore të materialeve propagandistike jo më vonë se data 5.9.2023.

Me këtë afat, diskutime? Jo! Kalojmë në votimin e pikës 17!

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, Znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)***

***Kundër: S'ka!***

Miratohet me pesë vota pro!

Pika 18. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

***Kolegë, kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, Znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)***

***Kundër: S'ka!***

Miratohet me pesë vota pro!

Pika 19. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

**Znj. H. Vukaj:** Para se të kalojmë në këtë pikë, zonja Nano, do të preferoja të ishte në këtë draft pika “kush ngarkohet”, por meqenëse këtu përmendim një numër institucionesh, justifikohet me këtë fakt. Nga ana tjetër përsëri kjo na jep shtysën që këto do të jenë institucionet që do të ngarkojë. “Ngarkohen institucionet e përmendura në këtë akt”.

**Znj. I. Nano:** Administrata e KQZ-së dhe institucionet...

**Znj. H. Vukaj:**...institucionet e përmendura në këtë akt...”

**Znj. I. Nano:**...në zbatimin e këtij vendimi”. Atëherë pas pikës 18 kemi propozimin të shtojmë një pikë 19 sipas propozimit që sapo prezantoi zonja Vukaj.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, Znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Kundër:** S’ka!

Miratohet me pesë vota pro!

Pika 20. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, Znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Kundër:** S’ka!

Miratohet me pesë vota pro!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit. Edhe njëherë kolegë dakordësinë tuaj, ose jo në lidhje me projektvendimin.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela, Znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.08.2023*

***Kundër: S'ka!***

Miratohet me pesë vota pro!

Duke qenë se nuk kemi çështje tjetër në rendin e ditës për të shqyrtuar, mbledhjen e deklarohet të mbyllur, faleminderit!

**Vendimi nr. 28**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

